Olimpi

NUMËR 03 | NËNTOR 2019

KOSOVO

Patra 2019: Arti Krasniqit për pak i iku medalja | Konferenca Forumi i KOK për Sportin hapi Javën Evropiane të Sportit



+3 MEDALJE BOTËRORE



MEDALJA E PARË NË EYOF



SHKËLQIMI I FUTBOLLIT

+3 World Medals | **First Medal at EYOF** | **Football shining**

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Ministry of Culture, Youth and Sport
iutecredit
MË TË SHPEJTIT DHE MË TË THJESHTIT
HIB PETROL
Hotel SIRIUS
CONFERENCE CENTER
TOYOTA
gjirafa.com
Physio MIRACLE
Fizioterapi & Mjekësi sportive
KOSOVAPRESS

KOSOVO

Olimpi - Revistë tre-muajshe (korrik, gusht, shtator 2019

Përgatiti: **Kushtrim Krasniqi**
Fotot: **Shpend Ahmeti, Kushtrim Krasniqi**
Fotot tjera: IJF, FFK, FBK, FKK, FHK, Facebook
Përkthimi: Translation Center

Botimi:
Komiteti Olimpik i Kosovës/Kosovo Olympic Committee
Adresa: Rruga Agim Ramadani,
Nr. 253, Kati i Parë, 10 000 Prishtinë

www.noc-kosovo.org
Rrjetet sociale:
https://www.facebook.com/kosovoolympiccommittee/
https://www.instagram.com/kosovoolympiccommittee/
https://twitter.com/NOCKOSOVO
https://www.youtube.com/channel/UCdU002ZSh8bs_mnGzv8fdKg

Dizajni: **Berat Ymeri**
Shtypi: **Shtypshkronja Blendi**





PËRMBAJTJA

04
+3 medalje botërore

06
Kosova e 16-ta nga 147 shtete

08
FALEMINDERIT JAPONI!

10
Shkëlqimi i futbollit

12
Mediat e huaja për Kosovën, para dhe pas ndeshjes me Anglinë

16
Nga mbipesha dhe sëmundja e bronkitit deri tek medalja e artë

18
Kosova doli e 26-ta nga 50 shtete në EYOF Baku 2019

22
Kosova debutoi në Lojërat Mesdhetare në Rërë Patra 2019

KALENDARI I LOJËRAVE 2019-2020

Lojërat Olimpike Dimërore për të Rinj Lozana 2020

09-22.01.2020

Lojërat Olimpike Verore Tokyo 2020

24.07-09.08.2020

KOSOVO

Plus 3



Edhe tre mujorëshi i kaluar (korrik, gusht, shtator 2019) pasuroi sportin tonë me suksese të mëdha të sportistëve tanë. Befasia më e këndshme erdhi nga Festivali Olimpik Evropian për të Rinj Baku 2019. Atleti me të ardhme të ndritur, Muhamet Ramadani, fitoi medaljen e artë në hedhjen e gjylës 5 kilogramë, duke i sjell vendit tonë medaljen e parë nga një Festival i tillë.

Një muaj më pas (gusht) notari Arti Krasniqi për pak i shpëtoi medalja. Krasniqi që la Gjermaninë për Kosovën, doli i katërti në maratonën e notit 5 km në ujëra të hapura në debutimin e Kosovës në Lojërat Mesdhetare të Rërës Patra 2019. Në Patra të Greqisë, paraqitje të kënaqëshme patën edhe dy ekipet e beach volleyt.

Xhudo vazhdoi me serinë e medaljeve të fituara këtë verë, të nisura rrufeshëm në Lojërat Evropiane Minsk 2019, ku u fituan tri medalje të ndryshme nga Majlinda Kelmendi, Nora Gjakova e Loriana Kuka. Këtë herë medaljet erdhën nga ABC-ja e xhudos, nga vendi ku verën e ardhshme Kosova do të shënojë pjesëmarrjen e dytë në Lojërat Olimpike Tokyo 2020. Botërori i Tokyo 2019 rezultoi me tri të bronzta të fituara nga Majlinda Kelmendi, Distria Krasniqi dhe Loriana Kuka. Ato e renditën vendin tonë në kreun e shteteve me më së shumti medalje të fituara në Tokio 2019.

Në një tjetër botëror, atë të mundjes Astana 2019, Egzon Shala, për pak nuk fitoi normën Olimpike. Doli i shtati. Gjashtë vendet e para morën vizën për Tokio 2020.

Futbolli vazhdon shkëlqimin. Në stadiumin "Fadil Vokrri" mposhtet njëra prej kombëtareve më të forta, Republika e Çekisë. Shtatori solli edhe ndeshjen tjetër të madhe, atë me Anglinë në Southampton, ku kombëtarja jonë për pak nuk shkaktoi befasinë më të madhe botërore. Humbi, por shkëlqeu tek kombëtarja që zbuloi futbollin. Ëndrra e futbollit tonë për kualifikim vazhdon…

Hendbolli shkroi historinë duke u bërë kombëtarja e parë ekipore pjesëmarrëse në një botëror. Këtë e bënë U-21 (meshkujt) që luajtën në Pontevedra të Spanjës dhe lanë përshtypje mbresëlënëse. U paraqitën me të gjitha simbolet tona. Ngritje po shënon edhe basketbolli, +21 vende në renditjen e FIBA-s.

KOK vazhdoi me organizitimin e aktiviteteve. Më 23 shtator 2019 mbajti konferencën "Forumi për Sportin", që hapi Javën Evropiane të Sportit. Ligji për Sponsorizim, Kriteret per Kategorizimin e sporteve, Barazia Gjinore dhe tema tjera bënë që aktiviteti të jetë tejet joshës dhe atraktiv për pjesëmarrësit e shumtë. E falë Ligjit për Sponsorizim, familjes Olimpike iu shtuan edhe sponsorët e rinj, Gjirafa e Physio Miracle. Së shpejti edhe shumë të tjerë.

Kick-boksi, triatloni, muaythai, ragbi, punëtorët sportivë, janë pesë federatat që kryen me sukses kursin për administrator sporti të organizuar nga KOK, ndërsa tenisi mbajti nivelin e parë të kursit për trajnerë.

Krahas sukseseve, ky tre mujorësh diti të sjellë edhe lajmin e kobshëm. Në mesin tonë nuk është më njeriu me inteligjencë të rrallë dhe virtyte të larta shoqësore. Lamtumirë Artan Venhari, kryetar i Federatës Aeronautike të Kosovës.

Besim Hasani
President i Komitetit Olimpik të Kosovës

Plus 3

Our sports have flourished with the great successes of our athletes over last quarter (July, August, September 2019). The most pleasant surprise came from the Baku 2019 European Youth Olympics Festival. Muhamet Ramadani, a promising athlete with a bright future, won gold in the 5kg shot put, bringing our country the first medal from such a Festival.

One month later (August), swimmer Arti Krasniqi narrowly missed the medal. Krasniqi, who opted for Kosovo over Germany, ranked fourth in the 5km open-water marathon on Kosovo's debut at the Mediterranean Beach Games, Patras 2019. The two beach volleyball teams also performed well in Patras, Greece.

Judo added the series of medals won this summer, after the blazing run at the 2nd European Games Minsk 2019, where three medals were won by Majlinda Kelmendi, Nora Gjakova and Loriana Kuka. This time, the medals came from the birthplace of judo, where Kosovo will mark its second participation in the Tokyo 2020 Olympics next summer. The Tokyo 2019 World Cup brought three bronze medals won by Majlinda Kelmendi, Distria Krasniqi and Loriana Kuka. They ranked our country between the top states with the most medals won in Tokyo 2019.

In another world cup, that of the Astana 2019 World Wrestling Championships, Egzon Shala almost reached the Olympic norm. He ranked seventh. The top six wrestlers received a Tokyo 2020 visa.

Football continues to shine. At the "Fadil Vokrri" Stadium one of the strongest national teams, the Czech Republic, was defeated. September brought the next big match, against England at Southampton, where our national team almost managed to stun the world of football. They lost, having played as equals against the national team of the country that invented football. Our dream of qualification to the European Football Championship goes on…

Handball made history by becoming our first national team participating at a world cup. This was achieved by the U-21 team (men), who played in Pontevedra, Spain, and made an impressive performance. They carried all our symbols at this world event. Basketball has also climbed +21 ranks in the FIBA rankings.

The KOC continued with the organization of activities. On September 23, 2019, it held the "Forum for Sports" conference, which opened the European Sports Week. The topics related to the Law on Sponsorship, Sports Categorization Criteria, Gender Equality, and other issues, turned the conference into a very attractive and fruitful event for the many participants. Thanks to the Law on Sponsorship, our new sponsors, Gjirafa and Physio Miracle, joined the Olympic family. Soon, many more will follow.

Kickboxing, triathlon, muaythai, rugby, sports workers, are the five federations that successfully completed the sports administrator course hosted by the KOC, while tennis held the first level of the coaching course.

Alongside these successes, this quarter also brought much grief. We have lost a man of rare intelligence and high social virtues. Farewell to Artan Venhari, President of the Kosovo Aeronautical Federation.

Besim Hasani
President of the Kosovo Olympic Committee

+3 medalje botërore

Kombëtarja e Kosovës në xhudo fitoi tri medalje botërore në Kampionatin Botëror Tokio 2019, të mbajtur në fund të muajit gusht.

Majlinda Kelmendi (-52 kg), Distria Krasniqi (-48 kg) dhe Loriana Kuka (-78 kg) fituan të tri nga një medalje të bronztë.

Nora Gjakova zuri vendin e shtatë në kategorinë e saj (-57 kg), ndërsa Akil Gjakova (-73 kg) u ndalë në luftën e dytë.

Krahas medaljeve, xhudistët tanë fituan edhe pikë Olimpike. Majlinda, Distria dhe Loriana fituan nga 1 mijë pikë, Nora 520, ndërsa Akili 240.

Të gjithë sportistët me sukses po e ndjekin normën Olimpike Tokio 2020.

+3 World Medals

The National Judo Team of Kosovo won three World Medals in the World Championship in Tokyo 2019, held in late August.

Majlinda Kelmendi (-52 kg), Distria Krasniqi (-48 kg) and Loriana Kuka (-78 kg) each won a bronze medal.

Nora Gjakova was seventh in her own category (-57 kg), while Akil Gjakova (-73 kg) was stopped at his second fight.

Along With their medals, our judo athletes gained their Olympic scores as well. Majlinda, Distria and Loriana gained 1000 points each, Nora got 520, and Akil got 240.

All our athletes are successfully pursuing the Olympic Quota for Tokyo 2020.



Dy medalje evropiane

Krahas botërorit në Tokio, xhudistët u dalluan edhe në Kampionatin Evropian U-21, të mbajtur në Vantaa të Finlandës.

Laura Fazliu (-63 kg) dhe Flaka Loxha (-57 kg), fituan medaljet e bronzta.

Për flakën ishte medalja e parë e saj në kampionat evropian.

Two European Medals

Along with the World Championship in Tokyo, our Judo fighters were excellent also in the European U-21 Championship held in Vantaa, Finland.

Laura Fazliu (-63 kg) and Flaka Loxha (-57 kg), won their bronze medals.

For Flaka, this was a first medal in an European Championship.



Kosova e 16-ta nga 147 shtete

Trajneri kampion Olimpik, Driton Kuka, ka komentuar suksesin e madh të ekipit të xhudos, të cilët fituan tri medalje të bronzta në Kampionatin Botëror Tokio 2019.

Kuka ka deklaruar se një rezultat i tillë vështirë të përsëritet.

"147 shtete pjesëmarrëse në Kampionatin Botëror në Tokio! Një statistikë interesante me numër të medaljeve, gjithsej tri të fituara. Kosova është në Top 5 ekipet e kësaj gare! Në një Sport Olimpik një rezultat të tillë do të jetë vështirë të përsëritet ndonjëherë", ka shkruar Kuka.

Kosova doli e 16-ta nga 147 shtete pjesëmarrëse.


Kosova ranks 16th out of 147 countries

Our Olympic Judo Champion Coach, Driton Kuka, commented on the great success reaped by the Judo Team, which won three bronze medals in the Tokyo World Championship 2019.

Kuka stated that such achievements are hard to repeat.

"147 countries competing in the World Championship in Tokyo! An interesting statistic of medals, a total of three won. Kosovo is amongst the top 5 teams in this competition! It is going to be very difficult to ever repeat such scores in an Olympic Sport", stated Kuka.

Kosova ranked 16th out of 147 countries.



Trajneri Driton Kuka me tri medaljet botërore



Live news

Kosovo, an unexpected world judo stronghold

Issued on: 24/08/2019 - 02:31

Pristina (AFP)

The young and tiny nation of Kosovo has emerged as a world judo power, its unexpected success spearheaded by diminutive Olympic champion Majlinda Kelmendi.

Eleven years after it gained independence from Serbia and in her first summer Olympics, Kelmendi's success in Rio in 2016 enabled Kosovo and its two million people to beat its big brother Albania that has never won an Olympic medal in any sport.

Kelmendi goes in search of more gold when she competes in the world championships in Tokyo that start on Sunday.

Kosovo's judo success story was created by coach Driton "Toni" Kuka in the small town of Pec where he founded a judo club with his brothers.

A training room with a leaky roof and worn carpets did not prevent the club from producing champions -- the authorities decided only recently to finance its renovation.

"I'm sure that if there was no Toni, Kosovo would not have all these medals today, especially the Olympic gold," Kelmendi, 28, told AFP.

She became a national hero thanks to her exploits in Rio, which followed world titles in 2013 and 2014.

In the poor Balkan country, where football is the main sport, the judokas can hardly expect to be top of the list for financial aid from the authorities. They receive only 250,000 euros ($281,000) annually, Kuka said, from the government's entire sports budget of 17 million euros.

- Revenge on history -

Kelmendi, who also holds European titles and dominated the European Games in Minsk this year, is the brightest star on Kuka's team. But she is no longer alone. She now leads a group whose members aspire for their share of world titles.

Distria Krasniqi, 25, is world junior champion and Nora Gjakova, 28, won bronze at the European championships.

"In different age categories, we now have 14 judokas who have reached the highest level," said 48-year-old Kuka.

Most come from the same neighbourhood.

By creating such a powerful team Kuka is taking revenge on Kosovo's turbulent history that took a heavy toll on

ADVERTISING
Ad closed by Google
Stop seeing this ad
Why this ad?

Kosova, një bastion i papritur në botën e xhudos", - shkrimi i gazetës franceze "France24" për xhudistët tanë

View: **Simple** | Expanded

Nation: ✖ Show all nations — Kosovo (KOS)

Search by name

Note: the information shown is **provisional** and only shows which judoka would be qualified, if the Olympic Games were today. The list will likely change significantly **until 30th May 2020**, which is the deadline for obtaining points for Olympic qualification.

Place	Competitor	Points	Qualification status
#3 in -48	KRASNIQI Distria	3965 points	Qualified
#5 in -57	GJAKOVA Nora	3240 points	Qualified
#3 in -52	KELMENDI Majlinda	3152 points	Qualified
#8 in -78	KUKA Loriana	2603 points	Qualified
#9 in -73	GJAKOVA Akil	2479 points	Qualified

Renditja Olimpike Tokio 2020 e xhudistëve tanë. Të pesë bursistët Olimpikë janë brenda normës Olimpike

FALEMINDERIT JAPONI!

Xhudistët tanë në Japoni janë pritur si heronj. Kampionëve tanë iu ishte rezervuar mikpritje e ngrohtë nga qyteti i Sanyos, aty ku për disa ditë xhudistët u përgatitën para botërorit të Tokyos.

Ekipi ynë u prit në aeroport me flamuj të Kosovës, ndërsa përkrahja ndaj tyre nuk mungoi edhe gjatë garave.

Dhjetëra japonezë me flamuj të Kosovës dhe fanella "Unë e dua Kosovën" përkrahën xhudistët tanë gjatë garave.

Trajneri Driton Kuka kishte thënë se një qytet (Sanyo City) po ndihet krenarë me praninë e xhudistëve tanë.

THANK YOU JAPAN!

Our Judo Athletes were honored as heroes in Japan. Our champions were greeted with warm hospitality of the Sanyo city, where our athletes stayed for their preparations before the Tokyo World Championship.

The athletes were welcomed with Kosovo flags at the airport, while great support was provided during the competitions.

Dozens of Japanese holding Kosovo banners and "I Heart Kosovo" shirts supported our Judo athletes during the competition.

Coach Driton Kuka said that the whole city (Sanyo City) displayed its pride for receiving our Judo team.









HIB PETROL



Shërbimi i mirë,
përcjellet me buzëqeshje.

Shkëlqimi i futbollit

Futbolli vazhdon të shkëlqejë. Kombëtarja jonë gjatë muajit shtator zhvilloi ndeshje me dy prej kombëtareve më të forta në Evropë dhe botë, në kuadër të kualifikimeve për EURO 2020.

Kombëtarja e drejtuar nga Bernard Challandes, mposhti Republikën e Çekisë në stadiumin "Fadil Vokrri" me rezultat 2:1.

Me golat e Vedat Muriqit dhe Mërgim Vojvodës, "Dardanët" shkaktuan njërën nga befasitë më të mëdha në kualifikimet për EURO 2020, derisa ngjallën shpresën për një kualifikim ëndrrash.

Tri ditë më vonë, Kosova udhëtoi në St'Marys të Southamptonit, për të luajtur ndeshjen me Anglinë, një takim që pak kush kishte ëndërruar se do të ndodhte 20 vjet më parë, kur vendi ynë doli nga lufta.

Kosova e përkrahur nga mijëra tifozë që kishin udhëtuar nga e mbarë Evropa, ia doli t'i shënojë tre gola Anglisë, përkundër që humbi 5:3.

Paraqitja e tyre u vlerësua me nota të larta. Kosova po shënon një histori të re, dhe më nuk iu takon kombëtareve të nivelit të ulët. 8 pikë në pesë ndeshje janë e arritur e madhe.

Football shining

Football continues to amaze In September, our national team had matches with two of the strongest national teams in Europe and the world, as part of qualifications for EURO 2020 championship.

The national team, led by Bernard Challandes, outmatched the Czech Republic at the "Fadil Vokrri" Stadium, at a score of 2:1.

With goals scored by Vedat Muriqi and Mergim Vojvoda, "Dardanians" caused one of the greatest surprises in the qualification stage for EURO 2020, while sparking great hopes for a miraculous qualification.

Three days later, Kosovo travelled to St'Mary's in Southampton, to play a game with England, a match that could hardly be imagined 20 years ago, when our country came out of the war.

With its support of thousands of fans traveling from all European countries, Kosovo was able to complete three goals, despite the loss of 5:3.

Their representation was highly appreciated. Kosovo is recording new history, and does not pertain anymore to the low-ranking nationals. 8 points in five matches are a great achievement.





Valon Berisha me shokë duke festuar golin e shënuar ndaj Anglisë në minutën e parë

Valon Berisha with his friends celebrating a goal against England already in the first minute



Pamje nga ndeshja Kosovë – R.Çeke, e zhvilluar në stadiumin Fadil Vokrri

Images from the Kosovo-Czech Republic match held at the "Fadil Vokrri" Stadium.



Pamje të tifozëve tanë në ndeshjen Angli - Kosovë

Kosovo's fans at St'Marys stadium in Southampton



Mediat e huaja për Kosovën, para dhe pas ndeshjes me Anglinë

Foreign media about Kosovo, before and after the match with England.

The remarkable Mr Vokrri: Kosovo's football rise

By Patrick Jennings
BBC Sport in Pristina

9 September 2019 | European Football | Share

[SPORT INSIGHT]



Fadil Vokrri (right) is considered the best footballer Kosovo has ever produced

All day the word "miracle" kept coming up. Maybe these thousands of people spilling out into Pristina's streets have just seen another.

It was September 2016 when Kosovo played their first competitive international football match.

On Saturday, they extended an unbeaten run to 15 games with possibly their most significant result yet - **a 2-1 home victory over the Czech Republic.** It

Sport > Football

Forged in the heat of war: the bloody history of Kosovo's football team

Twenty years after a brutal civil war brought the country to its knees a team of refugees is on the brink of qualifying for Euro 2020

By Robert O'Connor
Monday, 9th September 2019, 11:58 am
Updated Tuesday, 10th September 2019, 5:22 pm



Vedat Muriqi celebrates Kosovo's first goal against the Czech Republic (Reuters)

When Kosovo defender Mergim Vojvoda stuck out a hopeful boot to poke home his team's deciding goal in their 2-1 win against the Czech Republic on Saturday, 13,000 supporters in Pristina rose to their feet in joy, but not surprise.

Three months ago, Kosovo had never won a tournament qualifier. Now, off the





Falënderimi i tifozit nga Kosova për Anglinë
Kosovan fan thanking England

Kosovo

Kosovo's dream team is ready to inspire a more hopeful future

Exciting team that has grown up quickly has more than just possible Euro 2020 qualification as motivation



Nick Ames
@NickAmes82
Tue 10 Sep 2019 09.00 BST

201



▲ Kosovo celebrate their 2-1 win over the Czech Republic in their Euro 2020 qualifier. Photograph: Florion Goga/Reuters

During Kosovo's first World Cup qualifying campaign, a feeling spread through their squad and delegation that they were not being treated with enough respect. They could sense it, sometimes, through little things in an opponent's body language before a game or a disparaging comment during it. Although they took a single point from their attempt to reach Russia 2018, their performances against teams such as Croatia, Iceland, Ukraine and Turkey had merited more; the belief inside the dressing room was that they were not far off and if outsiders wanted to patronise them they had been through enough not to care.

They were right. Kosovo arrive in Southampton unbeaten in 15 games, fresh from a pulsating 2-1 win over the Czech Republic and with genuine hopes of reaching the European Championship at the first time of asking. It is the most exciting story on the continent's international scene; a tale of how a nation that declared independence in 2008, and did not join Uefa or Fifa until May 2016, has been able to express itself through a team whose possibilities currently appear limitless.



Southgate offers Declan Rice support over social media threats and abuse

"The dream keeps going," Samir Ujkani, the captain and long-serving goalkeeper, says. Few have lived that dream more intensely than him. On a filthy day in March 2014 he stood in a bog of a goalmouth in Mitrovica, a city in the north of Kosovo, as a hastily assembled Kosovo side prepared to face Haiti in their first Fifa-sanctioned friendly and could not keep the tears from his eyes.

Two and a half years later, after an unbearably tense wait in a hotel lobby in Turku, the emotions bubbled up again as he and five teammates were cleared to play in Kosovo's competitive debut against Finlan a matter of hours before kick-off

Sport > Football

Twenty years on from Kosovo's darkest hour, football is offering a bright new future

Long read: On 5 March 1998 the Yugoslav army launched an attack which changed the country forever. Two decades on, the country and its favourite sport has never felt more alive

Robert O'Connor | Monday 9 April 2018 11:36 |



FC Hajvalia warm up during a training session near Kishnica (Getty)

As the wind sweeps in south from the Klina freeway and the daylight cedes to dusk, the sleepy northern-Kosovan town of Skenderaj could be a thousand miles from anywhere. Spring has started. The cold, though, is perishing.

Dust kicks up off the road where the route in and out of town veers off to join a tarmacked forecourt from where the last bus service of the day has just departed for the capital. Two children kick a well-worn football up against the wall of the bus station, its leather panels flapping as it bounces back off the corrugated steel, the stitching long since having been eaten



Boris Johnson news: EU

◆ Premium

Sport › Football

'Forever grateful to you, our beloved England': Kosovo fans relish match between their two most-cherished nations

share

Save 23



Kosovo fans have gone to Southampton in huge numbers CREDIT: GETTY IMAGES

Follow

By **Sam Wallace**, CHIEF FOOTBALL WRITER
11 SEPTEMBER 2019 • 8:20AM

They had come from all over Europe and across the United Kingdom to St Mary's Stadium for a game that means more to the young nation of Kosovo than just another Euro 2020 qualifier in the life of this country and its emergent football team.

There were, according to official sources, 20,000 Kosovans expected in

SPORTS NEWS SEPTEMBER 11, 2019 / 1:22 PM / A MONTH AGO

Attacking Kosovo provide breath of fresh air

3 MIN READ

LONDON (Reuters) - Kosovo arrived like a breath of fresh sea air on England's south coast on Tuesday and while they were eventually swamped in a 5-3 defeat, the manner of their performance will have many hoping they qualify for the Euro 2020 finals.



Soccer Football - Euro 2020 Qualifier - Group A - England v Kosovo - St Mary's Stadium, Southampton, Britain - September 10, 2019 England's Marcus Rashford in action with Kosovo's Amir Rrahmani REUTERS/David Klein



Pamje nga ceremonia hapëse e Festivalit Olimpik Evropian për të Rinj Baku 2019. Bartëse e flamurit ishte xhudistja, Erza Muminoviq. Ekipi i Kosovës përbëhej nga 25 sportistë, trajnerë dhe zyrtarë.

Images from the Opening Ceremony of the European Youth Olympic Festival, Baku 2019. The flagbearer was our Judoka, Erza Muminoviq. The Kosovo team consisted of 25 athletes, trainers and officials.


KOSOVA
KOSOVA
LATVIA

Nga mbipesha dhe sëmundja e bronkitit deri tek medalja e artë

Atleti nga Mitrovica, Muhamet Ramdani, ka histori të jashtëzakonshme. Sportin e nisi me insistim të babait të tij, ngase vuante nga bronkiti dhe nga mbipesha. Pasi e fitoi luftën me dy të parat u zbulua talenti i tij i rrallë. Muhamet Ramadani ka hyrë në histori të sportit të Kosovës. Djaloshi i artë nga Mitrovica fitoi medaljen e artë në disiplinën: hedhje e gjyles 5-kilogramëshe në Festivalin Olimpik Evropian për të rinj (EYOF) "Baku 2019".

Shaban Ramadani, babai i Muhametit, nuk kishte shpresuar se djali i tij do të merrej me sport. Ai nga Mitrovica e kishte një brengë tjetër. Djali i tij po vuante nga mbipesha dhe nga problemet me sëmundjen e bronkitit. Duke e parë situatën Shabani kishte vendosur ta angazhonte birin e tij në ndonjë sport vetëm e vetëm që gjendja e tij të përmirësohej. Rastësisht Shabani ishte takuar me Mustafë Rrustemin, trajnerin e klubit të atletikës Trepça, prej të cilit kishte kërkuar këshilla se si të veprojë me Muhametin.

Rrustemi ia kishte hapur dyert e klubit të tij Muhametit të ri duke e angazhuar në disiplinën hedhje (shtytje) e gjyles. Ky sport solli rezultat shumë të suksesshëm për shëndetin e Metit, por gjithashtu edhe ia ka parë hairin këtij sporti duke i tejkaluar pritshmëritë.

Në sipërfaqe kishte nisur të dilte talenti i tij në këtë sport, duke shënuar rezultate pozitive, me të cilat vetëm pas tre vjetësh arriti të kualifikohet në ngjarjen më të madhe sportive në botën e të rinjve - në Olimpiadën Verore, që u mbajt në Buenos Aires. "Kam qenë me bronkit të madh dhe gjatë dimrit më është dashur të konsultohem me mjekun. Nga mbipesha e madhe babai është interesuar të inkuadrohem në atletikë. Si fillim e kam eliminuar bronkitin dhe pastaj kam filluar të përgatitem për gara", nis rrëfimin e tij 16-vjeçari.

Karrierën e ka nisur katër vjet më parë. Babai i Muhametit për të birin e ka ndërtuar rrethin e gjyles në oborrin e shtëpisë së tij. Pasioni për sportin nuk i ka munguar Shabanit. "Babai im ka qenë hendbollist. Më të ushtroj fitnes, atletikë dhe çdo gjë. Babai më është shndërruar në trajner personal", potencoi 'Meti'.

E shkroi historinë e sportit të Kosovës

Muhamet Ramadani ka hyrë në histori të sportit të Kosovës. Djaloshi i artë nga Mitrovica fitoi medaljen e artë në disiplinën Hedhje e gjyles 5-kilogramëshe në festivalin olimpik Evropian për të rinj (EYOF) "Baku 2019". Gjylen në largësi 19.75 metra, gati 1 metër më shumë se vendi i dytë Ramadani la pas rusin Semen Borodayev me rezultat 18.83 metra. Falë Ramadanit Kosova fitoi medaljen e parë dhe të vetme në EYOF "Baku 2019" dhe të parën për vendin tonë në tri pjesëmarrje të Lojërave Olimpike Evropiane për të Rinj.

Muhameti thotë se arritja e një suksesi të tillë nuk ka qenë aspak e lehtë. "Nuk ka qenë aspak e lehtë arritja e një suksesi të tillë, pasi kam stërvitur gati dy vjet për këtë garë. Mund të them se edhe gara ka qenë shumë e fortë, por ia dola", vlerësoi Ramadani.


Në momentin që e fitoi medaljen e artë Meti është ndier shumë krenar. "Jam jashtëzakonisht mirë, pasi e kam përfaqësuar shtetin tim".

Synimet e mëdha të Ramadanit

Mitrovicasi ka zbuluar synimet e tij për të ardhmen. Ato janë shumë të mëdha. "Vitin e ardhshëm synoj të bëhem kampion ballkanik me gjyle të 6 kilogramëve. Gjithashtu pretendoj të dal i pesti ose i gjashti në kampionatin botëror, i cili organizohet vitin e ardhshëm. Nuk do të ndalem së punuari, në mënyrë që të arrij sa më shumë në karrierë. Besoj se me punë arrihet çdo gjë", ka përfunduar bisedën Muhamet Ramadani.

Gjatë 2019-tës Muhameti fitoi tri medalje. Të parën e fitoi në Stamboll me gjyle të 6 kilogramëve (medaljen e bronztë) në një kampionat, në të cilin morën pjesë 20 shtete, kurse në qershor 2019 e fitoi medaljen e artë në Stamboll me gjyle të 5 kilogramëve.





Presidenti i Komitetit Olimpik të Kosovës, Besim Hasani, duke ia ndarë medaljen e artë Ramadanit

President of the Kosovo Olympic Committee, Besim Hasani, handing the gold medal to Ramadani.

From overweight and bronchitis having to a gold medal

The Athlete from Mitrovica, Muhamet Ramadani, wrote his name in Kosovo's history by winning the first medal, and Gold Medal, in the European Youth Olympic Festival (EYOF) in Baku.

However, the career of this 5 kg shot put athlete features a special story. When 12 years of age, he suffered from being overweight and bronchitis. For both these reasons, his father Shaban decided to place his son to sports.

After the advice by the athletics coach, Mustafe Rrustemi, Muhamet started working in athletics, focusing in shot put.

"I had major bronchitis, and in winter, I had to be examined by the doctor. Due to my obese weight, my father asked around for my involvement in athletics. I eliminated bronchitis for starters, and then I started training for competitions", the 16-year old begins the story.

His talent came to the surface, while the affection for the discipline only grew. His father built a playfield in his own yard.

Three years later, he was able to parttake in Summer Youth Olympics in Buenos Aires, in 2018. He ranked 12th between 15 athletes.

"My father used to be a handball player. I exercise do, my athletics and everything with him. My father has already turned into my personal coach", states Meti.

His full commitment for work reaped benefit this year, when winning a bronze medal in

6Kg Shot put in the Balkan Championship in Istanbul, held in February. In June, he won a Gold Medal in 5 kg, in the same championship, before winning gold at EYOF Baku 2019.



I gjithë ekipi i Kosovës ishte në mbështetje të Ramadanit

The whole Kosovo team cheering for Ramadani.

Kosova doli e 26-ta nga 50 shtete në EYOF Baku 2019

Ekipi Olimpik i Kosovës ka përfunduar në vendin e 26-të nga 50 shtete pjesëmarrëse në Festivalin Olimpik Evropian për të Rinj (EYOF), Baku 2019.

Ky sukses ka ardhur pas medaljes së artë të atletit Muhamet Ramadani. Ai fitoi të artën në disiplinën hedhje e gjylës.

Kosova la pas shtete të fuqishme si Hungaria, e cila fitoi 19 medalje, por jo edhe të artën, Zvicrën, Sllovenинë, Serbinë, etj.

Ekipi ynë u përfaqësua në kryeqytetin e Azerbajxhanit me 18 sportistë të pesë sporteve të ndryshme (xhudo, atletikë, not, mundje dhe tenis), ndërsa fitoi një medalje.

EYOF-i i ardhshëm 2023 do të mbahet në Banska Bistrica të Sllovakisë.

Kosova ranked 26th out of 50 countries competing at EYOF Baku 2019

The Kosovo Olympic Team ranked 26th in a list of 50 participating countries in the European Youth Olympic Festival (EYOF), held in Baku in 2019.

This score was made possible with the gold medal won by our athlete Muhamet Ramadani. He won gold in shot put.

Kosovo left behind powerful countries like Hungary, which won 19 medals, but not gold, Switzerland, Slovenia, Serbia, etc.

Our team presented in the capital of Azerbaijan with 18 athletes in five different disciplines, and won one medal.

The next 2023 EYOF shall be held in Banska Bistrica, Slovakia.

25	Israel	1	0	1	2	30
26	Kosovo	1	0	0	1	32
26	Austria	1	0	0	1	32
28	Hungary	0	9	12	21	9
29	Belgium	0	5	2	7	17
30	Switzerland	0	2	2	4	25
31	Republic of Moldova	0	1	4	5	21
32	Greece	0	1	3	4	25
32	Serbia	0	1	3	4	25
34	Portugal	0	1	0	1	32
34	Lithuania	0	1	0	1	32
36	Latvia	0	0	1	1	32



Atleti Muhamet Ramadani barti flamurin në ceremoninë mbyllëse të EYOF Baku 2019

The Athlete Muhamet Ramadani as flagbearer in the Closing Ceremony of EYOF Baku 2019



Sekretari i përgjithshëm i KOK-ut, Shasivar Haxhijaj, duke ndarë medaljet në atletikë

KOC Secretary General, Shasivar Haxhijaj, distributing medals in athletics

KOSOVO





Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Ministry of Culture, Youth and Sport

iutecredit
MË TË SHPEJTIT DHE MË TË THJESHTIT

HIB PETROL

Hotel SIRIUS
CONFERENCE CENTER

TOYOTA

gjirafa.com

Physio MIRACLE
Fizioterapi & Mjekësi sportive

KOSOVAPRESS

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Ministry of Culture, Youth and Sport

iutecredit
MË TË SHPEJTIT DHE MË TË THJESHTIT

HIB PETROL

Hotel SIRIUS
CONFERENCE CENTER

TOYOTA

gjirafa.com

Physio MIRACLE
Fizioterapi & Mjekësi sportive

KOSOVAPRESS

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Ministry of Culture, Youth and Sport

iutecredit
MË TË SHPEJTIT DHE MË TË THJESHTIT

HIB PETROL

Hotel SIRIUS
CONFERENCE CENTER

TOYOTA

gjirafa.com

Physio MIRACLE
Fizioterapi & Mjekësi sportive

KOSOVAPRESS

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Ministry of Culture, Youth and Sport

iutecredit
MË TË SHPEJTIT DHE MË TË THJESHTIT

HIB PETROL

Hotel SIRIUS
CONFERENCE CENTER

TOYOTA

gjirafa.com

Physio MIRACLE
Fizioterapi & Mjekësi sportive

KOSOVAPRESS

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Ministry of Culture, Youth and Sport

iutecredit
MË TË SHPEJTIT DHE MË TË THJESHTIT

HIB PETROL

Hotel SIRIUS
CONFERENCE CENTER

TOYOTA

gjirafa.com

Physio MIRACLE
Fizioterapi & Mjekësi sportive

KOSOVAPRESS


TOYOTA
COR HY19
COR HY19
COR HY19
www.toyota-kosovo.com

Kosova debutoi në Lojërat Mesdhetare në Rërë Patra 2019

Ekipi i Kosovës është përfaqësuar për herë të parë në Lojërat Mesdhetare në Rërë, që prej 25 gusht – 1 shtator 2019 u mbajtën në Patra të Greqisë.

Në ceremoninë hapëse, bartës i flamurit ishte ishte notari, Arti Krasniqi.

Kosova në Patra 2019 u përfaqësua me pesë sportistë. Krahas notarit Krasniqi, pjesëmarrës ishin edhe dy ekipet e beach volleyt: Dhuratë Sylejmani e Valmira Ramadani dhe Faton Mustafa e Armend Berisha.





Kosovo debuted at the 2019 Beach Mediterranean Games Patras 2019

The Kosovo team presented for the first time in the Mediterranean Beach Games between August 25 - September 1, 2019, held in Patras, Greece.

At the opening ceremony, the flag bearer was our swimmer Arti Krasniqi.

At Patra 2019 Games, Kosovo was represented by five athletes. Alongside swimmer Krasniqi, the games were attended by Beach volley teams: Dhuratë Sylejmani and Valmira Ramadani, and also Faton Mustafa and Armend Berisha.





Arti Krasniqit për pak i iku medalja: “Jam krenar që përfaqësova Kosovën”

29.08.2019 - Notari Arti Krasniqi për pak nuk arriti të fitojë medaljen e bronztë në Lojërat Mesdhetare në Rërë Patra 2019.

Notari ynë doli i katërti në disiplinën 5 kilometra në ujëra të hapura, nga 16 garues pjesëmarrës.

Koha e tij ishte 59 minuta e 49.10 sekonda, vetëm 22 sekonda më shumë se sa medalisti i bronztë, greku Georgios Arniakos. Dy vendet e para iu takuan italianëve: Andrea Manzi (57.57.20) dhe Marcello Guidi (57.57.8).

“Kam dhënë maksimumin, normal që pasi dola i katërti, jam pak i zhgënjyer që për pak nuk dola i treti, por edhe kjo pozitë është shumë e mirë për mua. Jam i kënaqur me paraqitjen. Gara nuk ishte e lehtë për shkak të valëve që mbretëronin”, deklaroi Arti Krasniqi për “noc-kosovo.org”.

Gara e tij u ndjek nga drejtuesit e Komitetit Olimpik të Kosovës dhe atë të Federatës së Notit të Kosovës, të cilët po ashtu mbetën të kënaqur me paraqitjen e shkëlqyeshme të Artit, i cili dëshmoi se ka cilësi dhe të ardhme të ndritur.

Arti ditë më parë vendosi të lë Gjermaninë për të përfaqësuar Kosovën. I pyetur se çfarë ndjenje ishte të përfaqësosh vendin e tij ai tha: “Jam krenar”.

Arti Krasniqi missed his medal: “Proud to represent Kosovo”

29.08.2019 - Swimmer Arti Krasniqi almost won a bronze medal at the 2019 Mediterranean Patra Sand Games.

Our swimmer finished fourth in the 5-kilometer discipline in the open-water race, between 16 competitors.

His time was 59 minutes and 49.10 seconds, only 22 seconds longer than bronze medalist, the Greek Georgios Arniakos. Two places belonged to the Italians: Andrea Manzi (57.57.20) and Marcello Guidi (57.57.8).

“I gave my best, and obviously I am a bit dissappointed for being fourth, I could have been third, but this position is good for me as well. I am satisfied with my presentation. The competition was not easy because of the reigning waves”, said Arti Krasniqi for “noc-kosovo.org”.

His race was attended by the leaders of the Kosovo Olympic Committee and the Kosovo Swimming Federation, who were also satisfied with the excellent presentation of Arti, who proved to have a bright future and qualities.

Only some days earlier, Arti decided to leave Germany to represent Kosovo. We asked what it was like to represent his own country, and he said: “I am proud”.




arena
Kosovo

Paraqitje e kënaqëshme e ekipeve të beach volleyt

Paraqitje të kënaqëshme në Lojërat Mesdhetare në Rërë Patra 2019, patën edhe ekipet e beach volleyt në të dyja konkurrencat.

Ekipi i meshkujve: Faton Mustafa e Armend Berisha, të prirë nga trajneri Bahri Gjinovci, hynë në top 12-she nga 16 ekipe. Vlen të përmendet fitorja ndaj Andorrës.

Ekipi i vajzave në përbërje: Valmira Ramadani e Dhuratë Sylejmani, të prira nga trajnerja Vildane Jashari, përkundur shortit të vështirë, bënë paraqitje të kënaqëshme në ndeshjet e humbura ndaj Sllovenisë dhe Francës.

A satisfactory representation of Beach Volley teams

A satisfactory representation at the Mediterranean Patras Sand Games 2019 was recorded for the Beach Volley in both disciplines.

Male Team: Faton Mustafa and Armend Berisha, lead by trainer Bahri Gjinovci, made the top 12 out of 16 teams. The win against Andorra was worth noting.

The women's team, made of: Valmira Ramadani and Dhuratë Sylejmani, lead by their coach Vildane Jashari, despite the difficult lot, had a rather satisfactory performance in their matches against Slovenia and France, albeit lost.





Drejtuesit e Komitetit Olimpik të Kosovës, presidenti Besim Hasani dhe sekretari i përgjithshëm, Shasivar Haxhijaj, morën pjesë në Asamblenë Gjenerale të Komitetit Ndërkombëtar të Lojërave Mesdhetare (ICMG), që u mbajtën në Patra të Greqisë.

Në Asamble u diskutuan tema të ndryshme si prezantimi i raporteve të punës dhe financiar të ICMG-së, LMR Patra 2019, zgjedhja e vendit organizator për organizimin e Lojërave të 20-ta Mesdhetare 2023, si dhe çështje tjera.

Seniors of the Kosovo Olympic Committee, President Besim Hasani and Secretary-General Shasivar Haxhijaj attended the General Assembly of the International Mediterranean Games Committee (ICMG), held in Patras, Greece.

The Assembly discussed various topics, including the presentation of ICMG's working and financial reports, reports on MG Patras 2019, the selection of the hosting country for the 20th Mediterranean Games 2023, and other matters.



Një foto e përbashkët e ekspeditës së Kosovës dhe mysafirëve të Federatës së Volejbollit të Kosovës
A joint photo of the Kosovo Expedition and guests of the Kosovo Volleyball Federation.

Kick-boksi kreu me sukses kursin për administratorë sporti

19 gusht - Federata e Kick-Boksit të Kosovës është bërë e 24-ta që ka përfunduar me sukses kursin për administratorë sporti, të organizuar nga Komiteti Olimpik i Kosovës.

Për dy ditë radhazi përfaqësuesit e Federatës së Kick-Boksit të Kosovës dhe klubeve të këtij sporti, mësuan për realizimin e planit strategjik 2019-2024.

Ligjërues të rregullt ishin: Besim Hasani (MEMOS XVIII) drejtor i programit për kurse/Solidaritet Olimpik-Komiteti Olimpik Ndërkombëtar dhe Elda Gjoka (MEMOS IX) drejtoreshë e kursit kombëtar, licencuar gjithashtu nga Solidariteti Olimpik i Komitetit Olimpik Ndërkombëtar.

Në ndarjen e certifikatave të nënshkruara nga Komiteti Olimpik Ndërkombëtar ishte edhe kryetari i Federatës së Kick-boksit të Kosovës, Fatmir Makolli.

Presidenti i KOK-ut, Besim Hasani tha se tani e tutje federatat dhe klubet mund të përfitojnë të hyra edhe nga Ligji për Sponsorizim.

"Bazuar në planin strategjik të KOK-ut, sa i përket kaptinës së ngritjes së kapaciteteve njerëzore, KOK brenda dy viteve ka organizuar 23 kurse për administratorë të sportit, dhe ky është i 24-ti ku po marrin pjesë hisedarët e federatës së kick-boksit. Interesimi është i madh, pjesëmarrësit mësuan elementet e para për hartimin e një plani strategjik që është i domosdoshëm për një federatë, sepse tani mundësitë janë jashtëzakonisht të mëdha që të gjenerojnë mjete, jo vetëm nga niveli qendror dhe lokal, por edhe nga Ligji për Sponsorizim", deklaroi presidenti Hasani.

Kryetari i Komisionit për Gjyqtarë të Federatës së Kick-Boksit të Kosovës, vlerësoi lart organizimin e këtij kursi.

"Është një kurs i mirëseardhur, në të cilin jemi duke parë mundësi të reja për krijimin e një plani strategjik, i cili është mjaftë i rëndësishëm për zhvillimin e kickboksit të Kosovës. Faleminderit kryetarit të KOK-ut, Besim Hasanit për mundësinë që na ka dhënë si federatë për ta ndjekur këtë kurs", u shpreh Shala.

Kursi për administratorë sporti mbështeten nga Solidariteti Olimpik i Komitetit Olimpik Ndërkombëtar.

Kick-boxing successfully completed the course for sports administrators

August 19 - the Kosovo Kick-Boxing Federation has successfully completed a course for sports administrators, conducted by the Kosovo Olympic Committee. For two consecutive days, representatives of the Kosovo Kick Boxing Federation and the clubs in this sport learned about the implementation of the Strategic plan 2019-2024.

Full-time lecturers were: Besim Hasani (MEMOS XVIII), Program Director for Courses / Olympic Solidarity-International Olympic Committee and Elda Gjoka (MEMOS IX) National Program Director, licensed by the International Olympic Committee's Olympic Solidarity.

The ceremony awarded of certificates and signed by the International Olympic Committee, was attended also by the President of the Kosovo Kickboxing Federation, Fatmir Makolli.

KOC President Besim Hasani said that from now on, federations and clubs could also benefit from the Law on sponsorship, while the chairman of the Kick Boxing Federation Referee Committee highly praised the organization of the course.

Sport Administrator courses are supported by the International Solidarity of the International Olympic Committee.




KOSOVO
KURSI PËR ADMINISTRATORËT E SPORTIT – FEDERATA E KICK-BOXIT E KOSOVËS
17-18.08.2019
Prishtinë, Kosova / Hotel Sirius
Udhëhequr nga / Facilitated by:
Ibër ALAJ
Drejtor Programi për kurse, SO-KON
MEMOS XIX
www.noc-kosovo.org
kosovoolympiccommittee
kosovoolympiccommittee/
NOCKOSOVO
iutecredit
TOYOTA
qiraja.com


Ramiz Smajli


KOSOVO
iutecredit
TOYOTA


COURSE FOR SPORT ADMINISTRATORS
KICK- BOX FEDERATION OF KOSOVO
Pristina, 17-18.08.2019

Triatloni dhe Muaythai kryen bashkërisht kursin për administratorë sporti

9 shtator - Për herë të parë dy federata, ajo e Triatlonit të Kosovës dhe Muaythait të Kosovës kryen bashkërisht kursin për administratorë sporti, të organizuar për tri ditë radhazi nga Komiteti Olimpik i Kosovës.

Vijuesit e të dy federatave mësuan për realizimin e planit strategjik 2019-2024.

Ligjërues të rregullt ishin: Besim Hasani (MEMOS XVIII) drejtor i programit për kurse/Solidaritet Olimpik-Komiteti Olimpik Ndërkombëtar dhe Elda Gjoka (MEMOS IX) drejtoreshë e kursit kombëtar, licencuar gjithashtu nga Solidariteti Olimpik i Komitetit Olimpik Ndërkombëtar, ndërsa për Hulumtimin Shkencor: "Lartësia e trupit në raport me parametrat tjerë Antropometrik për popullatën në Kosovë", ligjëroi PHD Fitim Arifi.

Vijuesit e këtij kursi patën mundësi të marrin edhe sqarimet e nevojshme nga sekretari i përgjithshëm i KOK-ut, Shasivar Haxhijaj, në lidhje me Ligjin për Sponsorizim dhe procedurat për të ardhur deri tek marrja e vërtetimit nga Ministria për Kulturë, Rini e Sport.

"Për herë të parë i kemi bërë bashkë dy federata, të cilat janë të formuara gjatë këtij viti dhe janë në një stag zhvillimor fillestar. Pjesëmarrja e tyre është relativisht masovike dhe do të vazhdojmë edhe më tej deri në përfundim të kurseve për të gjitha federatat në Kosovë", deklaroi presidenti Hasani.

Krahas zyrtarëve të federatës dhe klubeve, të pranishëm ishin edhe kryetarët e të dyja federatave: Shpëtim Ahmetaj (muaythai) dhe Vedat Tërmkolli (triatlon).

"Për tri ditë radhazi Federata e Muaythai Kosova po e vijon këtë kurs. Falënderoj KOK-un veçanërisht presidentin Hasnai për mundësinë e dhënë që të vijojmë këtë kurs. Me vijimin e këtij kursi Muaythai do të avancohet edhe më shumë si në menaxhim ashtu edhe në avancimin e të rinjve në muaythai", tha Ahmetaj.

Të gjithë pjesëmarrësit e rregullt morën certifikata të nënshkruara nga Komiteti Olimpik Ndërkombëtar.



Triathlon and MuayThai in a joint course for sports administrators

September 9 - For the first time, two federations, the Kosovo Triathlon and the Kosovo Muaythai Federation, attended a joint course for sports administrators for three consecutive days made possible by the Kosovo Olympic Committee.

Attendees from both federations learned about the implementation of the 2019-2024 strategic plan.

Full-time lecturers were: Besim Hasani (MEMOS XVIII), Program Director for Courses / Olympic Solidarity-International Olympic Committee and Elda Gjoka (MEMOS IX) National Program Director, licensed by the International Olympic Committee's Olympic Solidarity, while in Scientific Research: "Body height in relation to other Anthropometric parameters for the population of Kosovo", the lecturer was PHD Fitim Arifi.

Course attendees were also able to obtain necessary clarifications by the KOC Secretary General, Shasivar Haxhijaj, in relation with the Law on Sponsorship and the procedures for obtaining certificates from the Ministry of Culture, Youth and Sports.

"For the first time we have put together two federations, established during this year, which are at an early developmental stage. Their participation is relatively large and we will continue further until the completion of courses for all federations in Kosovo", stated President Hasani.

Along with Federation and club officials, present were also presidents of both federations: Shpëtim Ahmetaj (muaythai) and Vedat Tërmkolli (triathlon).

"Muaythai Federation of Kosovo is attending this three-day course. I would like to thank the KOC, and specifically President Hasani for the opportunity to attend the course. By attending this course, Muaythai will further enhance both in management, and in managing youth in Muaythai", said Ahmetaj.

All full-time attendees received certificates signed by the International Olympic Committee.









Pjesëmarrja e madhe e femrave dhe ndërkombëtarëve veçoi kursin për ragbi dhe punëtorët sportivë

Federata e Ragbit të Kosovës (FRK) dhe Federata Sportive e Punëtorëve të Kosovës (FSPK) kanë mbyllur me sukses kursin për administratorë sporti, të mbajtur për tri ditë radhazi në Hotel Sirius në Prishtinë.

Vijuesit e të dy federatave mësuan për realizimin e planit strategjik 2019-2024, në federatat dhe klubet e tyre. E veçanta e këtij kursi ishin numri i madh i pjesëmarrjes së femrave që tejkalonte atë të meshkujve, si dhe prania e përfaqësuesëve ndërkombëtarë që vinin nga Federata e Ragbit të Kosovës.

Ligjërues të rregullt ishin: Besim Hasani (MEMOS XVIII) drejtor i programit për kurse/Solidaritet Olimpik-Komiteti Olimpik Ndërkombëtar, Ibër Alaj (MEMOS XIX) SO-KON/drejtor programi dhe Elda Gjoka (MEMOS IX) drejtoreshë e kursit kombëtar, licencuar gjithashtu nga Solidariteti Olimpik i Komitetit Olimpik Ndërkombëtar, ndërsa për Hulumtimin Shkencor: "Lartësia e trupit në raport me parametrat tjerë Antropometrik për popullatën në Kosovë", ligjëroi PHD Fitim Arifi.

Vijuesit mësuan edhe detajet e Rregullores së Ligjit për Sponsorizim, si dhe procesin deri tek marrja e vërtetimit nga Ministria për Kulturë, Rini e Sport, të cilat ua shpjegoi Sekretari i Përgjithshëm i KOK-ut, Shasivar Haxhijaj.

"Për dallim nga kurset e kaluara, këtë herë kishim edhe ndërkombëtarë që po e ndihmojnë zhvillimin e sportit atraktiv siç është ragbi. Vijuesit po marrin informatat për të hartuar Planin Strategjik, ndërsa të pranishëm ishin edhe Federata Sportive e Punëtorëve të Kosovës, ku me interesim të jashtëzakonshëm e ndjekën kursin Bordi i kësaj federate", tha Presidenti i KOK-ut, Besim Hasani.

Për tri ditë radhazi në kurs ishte edhe kryetari i FSPK-së, Ismajl Sadiku. "Konsideroj që është një kurs jashtëzakonisht i mirë dhe i domosdoshëm për çdo federatë, klub dhe organizatë sportive", tha Sadiku.

Mark Barert nga Federata e Ragbit të Kosovës theksoi nevojën që kishin për të ndjekur këtë kurs, federata dhe klubet e këtij sporti, të cilat janë formuar këtë vit.

Vijuese e kursit ishte edhe Sekretarja e Përgjithshme e Federatës së Basketbollit të Kosovës, Elvira Dushku, e cila theksoi se kurset e tilla janë të mirëseardhura për federatat sportive, pasi bëhet fjalë për realizimin e Planit të Veprimit.

Kurset e tilla mbështeten nga Solidariteti Olimpik i Komitetit Olimpik Ndërkombëtar.



Large participation of women and internationals made the course for rugby and sports workers special

The Kosovo Rugby Federation (KRF) and the Kosovo Sports Workers' Federation (FSPK) successfully concluded a course for sports administrators, held for three consecutive days at the Sirius Hotel in Pristina.

Attendees from both federations learned about the implementation of the 2019-2024 strategic plan, in their federations and clubs. A special treat of this course was the large number of female attendees, that exceeded that of men, and the presence of foreign citizens part of the Kosovo Rugby Federation.

Full-time lecturers were: Besim Hasani (MEMOS XVIII), Program Director for Courses / Olympic Solidarity-International Olympic Committee, Ibër Alaj (MEMOS XIX) SO-IOC/Program Director, and Elda Gjoka (MEMOS IX) National Program Director, licensed by the International Olympic Committee's Olympic Solidarity, while in Scientific Research: "Body height in relation to other Anthropometric parameters for the population of Kosovo", the lecturer was PHD Fitim Arifi.

Attendees also learned the details of the Law on Sponsorship, and the procedure for obtaining certificates from the Ministry of Culture, Youth and Sports, clarified by the IOC Secretary General Shasivar Haxhijaj.

"For a difference from past courses, this time we had foreign citizens who are helping develop this attractive sport of rugby. Attendees obtained information on the manner of drafting a Strategic Plan, while the course was also attended by the Kosovo Sports Workers' Federation, and the Board of the Federation attentively attended the course", said KOC President Besim Hasani.

For three days in a row, the head of FSPK Ismajl Sadiku was also present. "I would consider it to be an extremely good and indispensable course for any federation, club or sport organization", said Sadiku.

Mark Barert from the Kosovo Rugby Federation emphasized the need the Federation and clubs in this sport, established this year, had to attend this course.

An attendee of the Course was also the Secretary General of the Basketball Federation of Kosovo, Elvira Dushku, who stated that such courses are welcome for sports federations, since this is about the implementation of the Action Plans.

Such courses are supported by the International Solidarity of the International Olympic Committee.







Konferenca Forumi i KOK për Sportin hapi Javën Evropiane të Sportit

23.09.2019 - Me konferencën Forumi i Komitetit Olimpik të Kosovës për Sportin, u hap Java Evropiane e Sportit, që u mbajt nën patronatin e Ministrit për Kulturë Rini e Sport, Kujtim Gashi.

Krahas ministrit Gashi që e bëri hapjen e Forumit, të pranishëm në Hotel Swiss Diamond në Prishtinë, ishin edhe dhjetëra përfaqësues të MKRS-së, përfaqësuesit më të lartë të federatave sportive, komunat, biznesi, si dhe Administrata Tatimore e Kosovës.

Temat që u trajtuan ishin: Ligji për Sponsorizim, Kategorizimi i Sportit, Sportistëve dhe Trajnerëve, ndërsa interesim të madh zgjoi edhe çështja e mbylljes së memorandumeve nga MKRS për federatat sportive, temë kjo e propozuar nga federatat.

"Pres që sot konkluzionet të jenë në dobi të sportit, temat që do trajtohen uroj të sjellin idetë dhe planet konkrete që do të avancojnë sportin në Kosovë. Që nga marrja e detyrës jam munduar maksimalisht të përmirësoj infrastrukturën sportive dhe të kemi imazh të mirë sportiv në arenën ndërkombëtare", tha ndër të tjera ministri Gashi, i cili më pas dha sqarimet e kërkuara nga federatat për mbylljen e memorandumeve.

Në fjalën e tij, Presidenti i KOK-ut, Besim Hasani, dha arsyet përse këtë herë vendosën të organizojnë Forumin për Sportin.

"Kemi zgjedhur kësaj radhe të organizojmë Forumin për Sportin dhe temat e përzgjedhura janë ato që preokupojnë sportin e Kosovës. Forumi do të jetë i rregullt në mënyrë që bashkërisht të hedhim ide dhe tema me interes të përgjithshëm dhe t'i trajtojmë ato së bashku", tha ndër të tjera presidenti Hasani.

Pjesëmarrës në panel për të diskutuar për Ligjin për Sponsorizim ishte edhe drejtori i Administratës Tatimore të Kosovës, Ilir Murtezaj, i cili dha sqarimet e nevojshme për bizneset që mund të sponsorizojnë në sport dhe të cilat do të kenë lehtësira nga tatimi në fitim.

Rregullorja e Ligjit për Sponsorizim, por edhe Rregullorja për Kategorizimin e Sporteve, Sportistëve dhe Trajnerëve, u prezantuan nga Sekretari i Përgjithshëm i KOK-ut, Shasivar Haxhijaj. Në temën e dytë, federatat propozuan ide për ndryshme në disa prej kritereve.

Tema tjetër që u trajtua ishte Qeverisja e Mirë në Sport, për të cilën foli Presidenti i KOK-ut, Besim Hasani.

Temat:

- **Ligji për Sponsorizim**
- **Kategorizimi i Sportit, Sportistëve dhe Trajnerëve**
- **Mbyllja e memorandumeve nga MKRS për federatat sportive**
- **Qeverisja e Mirë në Sport**

Sports Forum Conference kicks off the European Sports Week

23.09.2019 – The Kosovo Olympic Committee Sports Forum Conference officially kicked of the European Sports Week, which was held under the auspices of the Minister of Culture, Youth and Sports, Kujtim Gashi.

Besides Minister Gashi, who opened the Forum, present at the Swiss Diamond Hotel in Pristina were dozens of MCYS representatives, senior representatives of sports federations, and municipalities and businesses and the Kosovo Tax Administration.

Topics that were covered included: Law on Sponsorship, Categorization of Sports, Athletes and Trainers and the issue of the conclusion of MoUs between the MCYS and sports federations, a topic that had been proposed by the federations.

"I expect today's conclusions to be beneficial to the sports. I hope that topics to be addressed will help bring about concrete ideas and plans that will enhance the sports in Kosovo. Ever since I took office, I did my best to better the sports infrastructure and make sure that we have a good image in the international sports arena," Minister Gashi said.

In his speech, the President of the KOC, Besim Hasani, gave the reasons why they have decided to organize the Sports Forum this time.

"We have chosen to organize a Sports Forum this time, on the chosen topics that preoccupy Kosovo's sports. The forum will take place on regular basis, so that we can jointly give ideas and tackle issues of common interest," President Hasani said.

The Director of the Tax Administration of Kosovo, Ilir Murtezaj, also participated in the panel discussing the Law on Sponsorship and provided the necessary explanations about businesses that may sponsor sports and benefit from profit tax relief.

Another topic that was discussed was Good Governance in Sports, which the President of the KOC, Besim Hasani, spoke about. The European Sports Week in Kosovo, where various activities were organized, concluded on 30 September 2019.









14.08.2019 – Pak ditë pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Sponsorizim, drejtuesit e Komitetit Olimpik të Kosovës, presidenti Besim Hasani dhe sekretari i përgjjthshëm, Shasivar Haxhijaj, janë pritur nga drejtori i përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës, Ilir Murtezaj dhe ekipi i tij.
Drejtuesit e KOK-ut, e njoftuan drejtorin Murtezaj me pritshmëritë që ka komuniteti i sportit nga ATK për ta implementuar sa më shpejt këtë ligj.

KOK shënoi Ditën Ndërkombëtare të Turizmit me moton “Roli i Sportit në promovimin e Turizmit”

27.09 - Me moton “Roli i Sportit në promovimin e Turizmit”, Komiteti Olimpik i Kosovës ka shënuar Ditën Ndërkombëtare të Turizmit.

27 shtatori është Dita Botërore e Turizmit, që ka për qëllim ndërgjegjësimin në mesin e komunitetit ndërkombëtar për rëndësinë e turizmit dhe vlerat e tij sociale, kulturore, politike dhe ekonomike.

Me këtë rast, drejtuesit e KOK-ut, Presidenti Besim Hasani dhe Sekretari i Përgjithshëm, Shasivar Haxhijaj, tubuan në një tryezë, profesorë, biznesmenë dhe kryetarë të Federatave Sportive, ndërsa i pranishëm ishte edhe drejtori i Departamentit të Sportit në MKRS, Ibër Alaj.

Presidenti i KOK-ut, Besim Hasani, duke iu uruar mirëseardhje të pranishmëve, foli për idenë e kësaj tryeze, qëllimi i së cilës është promovimi sa më i madh i turizmit tonë përmes sportit. Ideja u mirëprit shumë mirë nga të pranishmit, të cilët theksuan nevojën e madhe që duhet të ketë promovimi i turizmit përmes sportit.

Të pranishmit duke folur për Ditën Ndërkombëtare të Turizmin falënderuan KOK-un për shënimin e kësaj dite, derisa theksuan se: “Sporti është ngushtë i lidhur me turizmin”.

Gjatë diskutimeve të temave të shumta, u konstatua se Kosova ka 46 për qind të territorit të saj me pyje, për të cilat u kërkua të ndalet prerja ilegale.

Të pranishmit theksuan se kapacitetet e Kosovës për turizëm janë shumë të mëdha falë konfiguracionit të saj, derisa u tha se sporti ka filluar shumë fuqishëm të kontribuojë në turizëm, qoftë përmes organizimit të garave sportive ndërkombëtare, si dhe promovimit të bukurive natyrore të Kosovës që po i bëjnë sportet dimërore dhe ato verore.

U konstatua që investimi në turizëm mund të jetë shtytësi më i madh i zhvillimit të ekonomisë së Kosovës.

Tutje, palët krahas investimeve të nevojshme që duhet të bëjë Qeveria e ardhshme, theksuan se investimi në turizëm ndikon tek rritja e të hyrave dhe krijimi i vendeve të reja të punës, gjersa për ta fuqizuar turizmin u konstatua se Qeveria e ardhshme duhet ta përfshijë Departamentin e Turizmit si pjesë e Ministrisë për Kulturë, Rini e Sport.

Rekomandimet që dolën nga tryeza: “Përmes Sportit ta promovojmë Turizmin”

- T’u jepet prioritet investimeve në Turizëm nga Qeveria e ardhshme, në mënyrë që të zhvillohet ekonomia dhe të krijohen vende të reja të punës
- Kërkohet të ndalohet dhënia e licencave dhe lejeve për ndërtimin e Hidrocentraleve në Qendrat Turistike dhe Sportive, të cilat e pengojnë zhvillimin e turizmit dhe aktiviteteve sportive, qoftë sporteve verore dhe dimërore.
- Të ndalohet prerja ilegale e pyjeve
- Të ruhet trashëgimia kulturore
- Kërkohet për federatat që të organizojnë sa më shumë ngjarje sportive ndërkombëtare në Kosovë, në mënyrë që t’i shërbejnë zhvillimit të turizmit.
- Për ta fuqizuar turizmin u kërkua nga Qeveria e ardhshme që Departamenti i Turizmit të bëhet pjesë e Ministrisë për Kulturë, Rini e Sport.
- U kërkua nga KOK-u të organizojë takime të rregullta, ku do vendoset për veprime konkrete për zhvillimin e turizmit përmes sportit.



KOC marked the International Tourism Day under the motto “The Role of Sport in Tourism Promotion”

27.09 - Under the motto “The Role of Sport in Tourism Promotion”, the Kosovo Olympic Committee celebrated the International Tourism Day.

September 27 is World Tourism Day, aimed at raising awareness among the international community about the importance of tourism and its social, cultural, political and economic values.

On this occasion, KOC heads, President Besim Hasani and Secretary General, Shasivar Haxhijaj, gathered at a roundtable an with professors, businessmen and presidents of Sports Federations, while the roundtable was also attended by the Director of the Department of Sports at MCYS, Ibër Alaj.

KOC President Besim Hasani welcomed the participants, and spoke about the idea of this roundtable, the purpose of which is to promote our tourism as much as possible through sports. The idea was warmly welcomed by the participants, who emphasized the great need to promote tourism through sport.

Speaking of the World Tourism Day, attendees thanked the KOC for celebrating this day, while emphasizing that: “Sports are closely linked to tourism”.

In discussing numerous topics, the conclusion was that Kosovo has 46 per cent of its territory covered in forests, the illegal logging of which needs to be prevented.

Attendees emphasized that Kosovo’s tourism capacities are large thanks to its configuration, while it was said also that sport has begun contributing into tourism, either through the organization of international sports competitions, but also in promoting natural assets in Kosovo through summer and winter games.

It was concluded that investment in tourism could be a major boost for Kosovo’s economic development.

Further, along with the necessary investments to be made by the future Government, the attendees stated that tourism investments contribute to extension of revenues and job creation, while to strengthen tourism, the future Government should involve a Department of Tourism into the Ministry of Culture, Youth and Sport.





www.hotelsirius.net

siriushotelks

Presidenti Hasani priti zyrtaren e lartë të Komitetit Olimpik të Gjermanisë, Celine Babiq

27.09.2019 - Presidenti i Komitetit Olimpik të Kosovës, Besim Hasani, ka pritur zyrtaren e lartë për Marrdhënie me Jashtë të Komitetit Olimpik të Gjermanisë, Celine Babiq, e cila shoqërohej nga drejtori teknik i Federatës së Futbollit të Kosovës, gjermani Michael Nees.

Presidenti Hasani duke i uruar mirëseardhje në Kosovë mysafires Babiq e falënderoi për bashkëpunimin e frytshëm që kanë dy Komitetet Olimpike, në veçanti kontributin që KO i Gjermanisë ka dhënë në procesin e ndërkombëtarizimit të Lëvizjes Olimpike në Kosovë.

Presidenti Hasani vlerësoi lartë kontributin e drejtorit tektnik në FFK, Nees, për punën e shkëlqyer në ngritjen e kapaciteteve të trajnerëve të futbollit sipas standardeve të UEFA-s.

Presidenti Hasani e njoftoi zyrtaren Celine Babiq me të arriturat e Komitetit Olimpik të Kosovës, me theks të veçantë medaljen e artë Olimpike të Majlinda Kelmendit, në debutimin e Kosovës në Lojërat Olimpike Rio 2016.

Nga ana e saj, Babiq falënderoi Presidentin Hasani për pritjen, derisa vlerësoi lartë të arriturat e KOK-ut për një kohë të shkurtër të anëtarësimit në KON.

Në fund të takimit të dy palët shkëmbyen dhurata.

President Hasani received Celine Babic from DOSB

27.09.2019 - The Kosovo Olympic Committee President, Besim Hasani, received the Senior External Relations Officer of the German Olympic Committee, Celine Babiq, accompanied by the technical director of the Kosovo Football Federation, Michael Nees.

Upon welcoming the senior official Babiq, President Hasani thanked for the fruitful cooperation between the two Olympic Committees, and specifically for the contribution of the German KO to the internationalization of the Olympic movement in Kosovo.

President Hasani highly appreciated the contribution of the FFK Technical Director, Nees, who has an excellent involvement in capacity building for football coaches to UEFA standards.

President Hasani briefed Senior Officer Celine Babic on the achievements of the Kosovo Olympic Committee, specifically emphasizing the Olympic gold medal of Majlinda Kelmendi, in Kosovo's debut at the Rio Olympics 2016.

From her side, Babic thanked President Hasani for the reception, while praising KOK's achievements for its short period of IOC membership.



KOK takoi bursistët Olimpikë Tokio 2020

Me qëllim të ngritjes së performancës në garat ndërkombëtare, si dhe përgatitjet që po i vijojnë, drejtuesit e Komitetit Olimpik të Kosovës, takuan ndarazi bursistët Olimpikë Tokio 2020.

Bursistët nga sported e atletikës, notit, boksit, mundjes, shigjetarisë dhe shenjëtarisë sportive, bashkëbiseduan me drejtuesit e KOK-ut për sfidat që kanë para vetes.

KOC met the Tokyo 2020 Olympic Fellows

With a view of improving performance in international competitions, and their preparations, leaders of the Kosovo Olympic Committee met the Tokyo 2020 Olympic Fellows.

Fellows in sports of athletics, swimming, boxing, wrestling, archery, and marksmanship spoke to KOC leaders about the challenges ahead.






KOSOVO
TAKIMI KOK - BURSISTËT
OLIMPIKË TOKIO 2020
iutecredit
TOYOTA
qirafa.com



gjirafa50.com

gjirafaMall.com

gjirafaVideo

gjirafaAdnetwork

gjirafaLab

gjirafaPikBiz

gjirafaOrto

GJIRAFA STUDIOS™

22 trajnerë përfunduan me sukses kursin e tenisit të mbështetur nga KOK-u

21.09.2019 - 22 trajnerë kanë përfunduar me sukses kursin për trajnerë të tenisit – niveli i parë, i mbajtur për 11 ditë në fushat e tenisit në Pejë.

Ligjërues ishin dy ekspertët ndërkombëtarë të Federatës Botërore të Tenisit (ITF), Ales Filipçiq nga Sllovenia dhe Vanja Ibrahimoviq nga Bosnja e Hercegovina, të cilët mbetën të kënaqur me performancën e treguar nga vijuesit, si në pjesën teorike, ashtu edhe në atë praktike.

"Trajnerët ishin shumë të motivuar. Kemi punuar gjatë tërë kohës. Kushtet ishin shumë të mira për punë. Kandidatët fituan dije dhe ishin aktiv gjatë tërë kohës", tha ndër të tjera, Filipçiq për RTV Dukagjinin.

Edhe trajnerët Julinda Elezi, Burim Gashi dhe Erion Xharavina u shprehën të kënaqur me njohuritë e reja të fituara nga ekspertët.

Kursi u mbështet nga Komiteti Olimpik i Kosovës dhe Solidariteti Olimpik i Komitetit Olimpik Ndërkombëtar.

22 trainers successfully completed the KOC-supported tennis course

21.09.2019 - 22 trainers successfully completed the course for tennis trainers - Level One, held for 11 days in the tennis courts in Peja.

Lecturers included two international experts from the International Tennis Federation (ITF), Ales Filipcic from Slovenia, and Vanja Ibrahimovic from Bosnia and Herzegovina, who were satisfied with the performance shown by attendees, both in theory and in practice.

"Trainers were very motivating. We worked all the time. We had very good conditions for work. Candidates gained knowledge and were active all the time", Filipcic told RTV Dukagjini.

Other trainers like Julinda Elezi, Burim Gashi and Erion Xharavina expressed their satisfaction with the new knowledge shared by the experts.

The course was supported by the Kosovo Olympic Committee and the International Olympic Committee's Olympic Solidarity.





Mirë se vjen Gjirafa në familjen Olimpike

07.08.2019 - Kompania e avancuar e teknologjisë, Gjirafa, i është bashkuar planit strategjik të marketingut të Komitetit Olimpik të Kosovës.

KOK dhe Gjirafa, kanë nënshkruar kontratën e sponsorizimit, e cila njëherit është e para që prej hyrjes në fuqi të Ligjit të Sponsorizimit në fushën e Sportit, Kulturës dhe Rinisë.

Kontrata është nënshkruar nga presidenti i KOK-ut, Besim Hasani dhe drejtori i përgjithshëm i platformës Gjirafa, Mërgim Cahani, ndërsa të pranishëm ishin edhe sekretari i përgjithshëm i KOK-ut, Shasivar Haxhijaj dhe drejtues tjerë të Gjirafës.

Presidenti Hasani tha se kjo ditë është e veçantë për dy gjëra të rëndësishme.

"Kjo është marrëveshja e parë pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Sponsorizime, për çka besoj se do të jetë një lajm i mirë, një hap i parë për të hapur rrugën edhe për marrëveshje tjera, jo vetëm që do të lidhen midis KOK-ut dhe etniteteve tjera, por edhe midis biznesit dhe organizatave tjera sportive, që janë federatat, klubet, por edhe sportistët", tha presidenti Hasani, në konferencën për media të organizuar në objektin e Gjirafës.

"E dyta e veçantë ndërlidhet pikërisht me 7 gushtin 2016, ku tri vite më parë e tronditëm botën me një lajm të jashtëzakonshëm, me një arritje të përmasave botërore, ku në shtetin që nuk na njeh, Brazilin, Majlinda Kelmendi rrëmbeu medaljen e artë dhe e renditi Kosovën në mesin e 100 shteteve me medalje të artë", shtoi i pari i Lëvizjes Olimpike në Kosovë.

Nga ana e tij, drejtori i përgjithshëm i Gjirafës, Mërgim Cahani, shprehu kënaqësinë që kompania që drejton do të jetë partner i Komitetit Olimpik të Kosovës.

"Jemi mbledhur sot për një arsye shumë të rëndësishme, pasi jemi duke krijuar partneritet Gjirafa me shërbimet e veta dhe me Komitetin Olimpik të Kosovës. Ne do të donim të inspiroheshim nga KOK-u dhe nga arritjet e sportistëve tanë në mbarë botën. Kjo për ne e bënë shumë të rëndësishme nënshkrimin e kësaj kontrate dhe bashkëpunimi ynë do të shtojë vlerat e të dyja palëve", deklaroi ndër të tjera Cahani.

Kontrata është një-vjeçare me mundësi vazhdimi edhe për vitet tjera.

Gjirafa, welcome to the Olympic family

07.08.2019 - the well-developed technology company, Gjirafa, joined the strategic marketing plan of the Kosovo Olympic Committee.

KOC and Gjirafa signed a sponsorship contract, which is the first from the entry into force of the Law on Sponsorship in the field of Sports, Culture and Youth.

The contract was signed by the president of KOC, Besim Hasani, and the general director of the Gjirafa platform, Mërgim Cahani, a ceremony also attended by the KOC Secretary General, Shasivar Haxhijaj, and other seniors of the Gjirafa company.

President Hasani said that this day is special for two important reasons:

"This is the first agreement after the Law on Sponsorship entered into force, and I believe this is great news, a first step in opening the way for other agreements, not just between KOC and other entities, but also between businesses and sports organizations, such as federations, clubs and athletes", said president Hasani, in a press conference organized at the Gjirafa facilities.

"A second important reason is linked to the date of 7 August 2016, three years ago, when we shook the world with tremendous news, a globally relevant achievement, in a non-recognizing state, Brazil, when Majlinda Kelmendi took the Gold Medal, and ranked Kosovo among the 100 gold medalist countries", said the head of the Olympic Movement in Kosovo.

For his part, the Director General of Gjirafa, Mërgim Cahani, expressed his satisfaction that the company he runs will be a partner of the Kosovo Olympic Committee.

"We have gathered here today for a very important reason, the establishment of a partnership between Gjirafa, with its services, and the Kosovo Olympic Committee. We are certain to be inspired by KOC and the achievements of our athletes globally. This adds up to the relevance of signing this contract, and we hope that this contract will add to our common values", said Cahani, amongst others.

The contract has a one-year term, with a possibility of extension for other years.




MERGIM CAHANI
CEO
BESIM HASANI
KOSOVO


gjirafa.com
kërko më gjithën tënde
PROUD PARTNER
Partner i
KOMITETIT OLIMPIK
TË KOSOVËS
KOSOVO


gjirafa50.com
MBI 50.000 PRODUKTE
Dyqani online më i madh për teknologji në Kosovë dhe rajon


KOSOVO
gjirafa.com
Partner i
KOMITETIT OLIMPIK
TË KOSOVËS
KOSOVO

KOK nënshkruan kontratë sponsorizimi me Kompaninë Physio Miracle

22.08.2019 - Në vazhdën e nënshkrimeve të kontratave me sponsorë, pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Sponsorizim, Komiteti Olimpik i Kosovës sot ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me Kompaninë Physio Miracle, e cila ofron shërbime fizioterapeutike dhe mjekësi sportive.

Kontrata e vlefshme një-vjeçare, por me mundësi vazhdimi, u nënshkrua në zyret e KOK-ut, nga presidenti i KOK-ut, Besim Hasani dhe drejtori i Physio Miracle, Bernard Tahirbegolli.

Presidenti Besim Hasani deklaroi se kontrata parasheh që tani e tutje sportistët elitarë, bursistët Olimpikë dhe Shpresat Olimpike 2019, të mund të kryejnë kontrollet në këtë qendër.

I pari i Lëvizjes Olimpike në Kosovë, Besim Hasani, ftoi të gjithë sportistët elitarë, që testimet tash e tutje t'i bëjnë në Physio Miracle, e cila do të përkujdeset në maksimum për përmirësimin e shëndetit dhe performancën e sportistëve.

Nga ana e tij, drejtori i Physio Miracle, Bernard Tahirbegolli, shprehu kënaqësinë e fillimit të bashkëpunimit me KOK-un dhe sportistët elitarë.

KOC signed a sponsorship contract with Physio Miracle Company

22.08.2019 - In a series of sponsor contracts signed after the entry into force of the Law on Sponsorship, the Kosovo Olympic Committee today concluded a cooperation agreement with the Physio Miracle Company, which provides physical therapy and sports medicine services.

This one-year contract, with a possibility of extension, was signed at KOC offices by KOC President Besim Hasani, and the Director of Physio Miracle Director Bernard Tahirbegolli.

President Besim Hasani said that the contract stipulates that elite athletes, Olympic Fellows and Olympic Hopes 2019, shall take their examinations at this center.

The head of the Olympic Movement in Kosovo, Besim Hasani, encouraged all elite athletes to carry out their examinations at Physio Miracle, which has pledged to provide their maximum efforts to improve the health condition and performance of athletes.

For his part, Director of Physio Miracle, Bernard Tahirbegolli, expressed his satisfaction with the start of cooperation with the KOC and elite athletes.







Physio MIRACLE

Fizioterapi & Mjekësi sportive







+383 44 100 044 physio@yesspharma.com

Drejtuesit e KOK-ut zhvilluan takime me ministrat

Gjatë muajit korrik 2019 drejtuesit e Komitetit Olimpik të Kosovës, presidenti Besim Hasani dhe sekretari i përgjithshëm, Shasivar Haxhijaj, kanë zhvilluar takime ndarazi me disa prej ministrave të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Ata takuan ministrin e Mbrojtes, Rrustem Berisha, ministrin e Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, ministrin e Punëve të Brendshme, Ekrem Mustafa.

Gjatë takimeve, presidenti Hasani dhe sekretari i përgjithshëm, Hahijaj, kanë kërkuar punësimin e sportistëve elitarë nëpër Ministri, themelimin e Federatës Ushtarake të Sporteve Brenda FSK, pajisjen e sportistëve elitarë me pasaporta biometrike, etj.

Të gjitha këto kërkesa gjetën përkrahjen e ministrave, të cilët u shprehën të gatshëm për të vazhduar bashkëpunimin me KOK-un.

KOC leaders held meetings with the ministers

During July 2019, heads of the Kosovo Olympic Committee, President Besim Hasani and the Secretary General Shasivar Haxhijaj, held separate meetings with some of the Ministers of the Government of the Republic of Kosovo.

They met with the Minister of Defense, Rrustem Berisha, Minister of Foreign Affairs, Behgjet Pacolli, and the Minister of Internal Affairs, Ekrem Mustafa.

During the meetings, President Hasani and the Secretary General Haxhijaj requested the employment of elite athletes in the Ministries, the establishment of the Military Sports Federation within the KSF, provision of elite athletes with biometric passports, etc.

All these requests received the support of the ministers, who expressed their readiness to continue cooperation with the KOC.







KOSOVAPRESS

AGJENCI E LAJMEVE / NEWS AGENCY

KosovaPress ju ofron shërbimin e përditshëm të lajmeve (7 ditë në javë) nga Kosova, rajoni dhe bota, për sektorët e politikës, ekonomisë, etj, nga ora 06.00 deri me 24.00. Prioritet i redaksisë janë temat, intervistat, reportazhet nga politika, ekonomia, çështjet sociale, kulturore, e të tjera.

KosovaPress përveç lajmeve me tekst ju ofron edhe shërbimin e Video Lajmeve, Audio Lajmeve dhe Fotove.

KosovaPress ju ofron shërbimin e lajmeve në dy gjuhë, gjuhën shqipe dhe angleze.

SHËRBIMI I PËRGJITHSHËM:

- Video Lajme
- Lajme tekst
- Audio Lajme / Foto
- Lajmet ne gjuhen angleze
- Video aktivitete Live




EMISIONET

Departamenti i Produkcionit të KOSOVAPRESS-it prodhon edhe emisione të ndryshme për televizionet vendore dhe ato jashtë vendit.

1. Emisione Familjaro-Edukative me qasje informuese për publikun
2. Promocional për Bizneset
3. Informues dhe Argëtues me qëllim të përmirësimit dhe informimit të drejtë të publikut

- Prodhimin e Videospoteve, Storieve, Dokumentarë
- Reklamimi në web dhe Emisionin Foleja



WWW.KOSOVAPRESS.COM

Presidenti Hasani ishte panelist në Samitin Inter-Regjional të SIGA-s, foli për ëndrrën dhe sukseset e sportistëve të Kosovës

17.09.2019 - Presidenti i Komitetit Olimpik të Kosovës, Besim Hasani, ishte pjesëmarrës në cilësinë e panelistit në Samitin e dytë Inter-Regjional të SIGA-s (Aleanca Globale për Integritet në Sport), me temë: "Integriteti Sportiv - Fuqia e Veprimit Kolektiv në Lindjen e Mesme, Azi dhe Afrikë", që për dy ditë u mbajt në Doha të Katarit.

Presidenti Hasani foli për ëndrrën 22-vjeçare të liderëve sportivë të Kosovës për ndërkombëtarizimin e sportit, për medaljen e artë Olimpike të fituar nga Majlinda Kelmendi në debutimin e Kosovës në Rio 2016, si dhe sukseset tjera që e kanë përshkruar sportin tonë që prej ndërkombëtarizimit.

Krahas rezultateve në sport, i pari i Lëvizjes Olimpike në Kosovë, Besim Hasani, shfaqi edhe një herë synimet e KOK-ut për të arritur nivelin më të lartë organizativ.

"Një prej ëndrrave të Komitetit Olimpik të Kosovës është të bëhemi prej 1-10 Komitetet më të mira të botës, jo vetëm për nga rezultatet e sportistëve, por edhe me qeverisjen e mirë, me kultivimin e integritetit dhe kredibilitetit për Organizatat Sportive që i udhëheqim, duke ngritur kapacitetet e Burimeve Njerëzore me transparencë, llogaridhënie në funksion të ruajtjes së autonomisë së Organizatave Sportive (klubet, federata, KOK) etj", tha ndër të tjera Presidenti Hasani.

Për dy ditë me radhë në Samit u diskutuan çështje të ndryshme të integritetit sportiv.

Samiti i tretë Inter-Rajonal i SIGA-s, mbahet më 10 dhjetor 2019, në Prishtinë

Kujtojmë që Samitin e parë Regjional të SIGA-s e ka mbajtur Kosova më 5 shtator 2018, kurse Samiti i tretë Inter-Regjional do të mbahet sërish në Prishtinë më 10 dhjetor 2019, pikërisht në pesë vjetorin e njohjes së Komitetit Olimpik të Kosovës nga Komitetit Olimpik Ndërkombëtar.

President Hasani served as a panel member at the SIGA Inter-Regional Summit

17.09.2019 - the President of the Kosovo Olympic Committee, Besim Hasani, took part as a panel member in the Second SIGA Inter-Regional Summit (Sport Integrity Global Alliance), addressing the topic: "Sport Integrity - The Power of Collective Action in the Middle East, Asia and Africa", which was held for two days in Doha, Qatar.

President Hasani spoke about the 22 year long dream of sports leaders of Kosovo for internationalizing sports, the Olympic gold medal won by Majlinda Kelmendi in Kosovo's debut in Rio 2016, and other successes that have marked our sports since our internationalisation.

Along with sports results, the lead of the Olympic Movement in Kosovo, Besim Hasani, expressed once more the goals of KOC to achieve the highest organizational level.

"One of the dreams of the Kosovo Olympic Committee was to become one of the world's top 10 Committees, not only in terms of athletes' results, but also in good governance, by cultivating integrity and credibility for the Sports Associations we run, building human resource capacities with all transparency, accountability in a view of preserving autonomy of Sport Organizations (clubs, federations, KOC, etc.)", stated, amongst others, President Hasani.

For two days, the Summit discussed various matters related to sport integrity.

The the third SIGA Interregional Summit will be held in Prishtina, on December 10, 2019.

We remind ourselves that the first SIGA Regional Summit was held by Kosovo on September 5, 2018, while the third Inter-Regional Summit will be held again in Pristina on December 10, 2019, on the fifth anniversary of the Kosovo Olympic Committee's recognition by the International Olympic Committee.





Bordi Ekzekutivi i KOK-ut mbajti tri mbedhje gjatë muajëve korrik, gusht dhe shtator. Bordi shqyrtoi pika të shumta të Rendit të Ditës.

Lojërat dhe sportet tradicionale së shpejti me federatë

09.09.2019 - Drejtuesit e Komitetit Olimpik të Kosovës, presidenti Besim Hasani dhe sekretari i përgjithshëm, Shasivar Haxhijaj, kanë takuar nismëtarët e themelimit të Federatës së Lojërave dhe Sporteve Tradicionale të Kosovës.

Prej shumë dekadash në shumë vende në Kosovë vazhdon tradita e ruajtjes së sporteve tradicionale, por që themelimi i një federate gjithnjë kishte munguar.

Për ta aktivizuar federatën dhe bashkërisht edhe klubet e shoqatat nëpër rajone, në zyret e KOK-ut u mbajt takimi me disa prej nismëtarëve, të cilët prej vitesh organizojnë lojëra të ndryshme tradicionale.

Pas diskutimeve të shumta palët u dakorduan që të mbahet Kuvendi Themelues i kësaj federate dhe njëkohësisht të zgjedhen organet drejtuese. Në themelimin e kësaj federate do të kontribuojë edhe vetë KOK-u.

Në emër të nismëtarëve, profesori Fadil Hysa shprehu kënaqësinë për nismën e marrë, me besimin se në shumë Komuna do të formohen klube dhe shoqata të cilat me dekada ruajnë sportet tradicionale.

Traditional games and sports soon with an own federation



09.09.2019 - Heads of the Kosovo Olympic Committee, President Besim Hasani and Secretary General Shasivar Haxhijaj, met with the pioneers of establishing the Federation of Traditional Games and Sports of Kosovo.

For many decades, the tradition of preserving traditional sports has continued in many areas in Kosovo, but a federation was never established.

To activate the federation, and in parallel also the clubs and associations in regions, KOC met with some of the initiators who have been organizing various traditional games for years.

Upon lengthy discussion, parties agreed to hold the Founding Assembly for this Federation, where the governing authorities would be elected. KOC itself would contribute to the establishment of this federation.

On behalf of the initiators, Professor Fadil Hysa expressed his satisfaction with the initiative taken, thereby expressing his conviction that many municipalities will establish their clubs and associations, for their long preserved traditional sports.

Hendbolli shkroi historinë në Spanjë

Kombëtarja U-21 e Kosovës në hendboll u bë e para që mori pjesë në një kampionat botëtor të sporteve ekipore, të mbajtur në korrik 2019 në Pontevedra të Spanjës.

Edhe pse zunë vendin 23 nga 24 shtete, djelmoshat tanë lanë përshtypje të mira edhe ndaj kombëtareve favorite për të fituar botërorin.

Grupi i Kosovës ishte shumë i fortë dhe kështu kalimi i tij me sukses ishte vështirë i arritshëm. Pos me Kroacinë, kombëtarja jonë ka humbur edhe me Hungarinë, Portugalinë dhe Brazilin. Në fund barazoi me Bahrejnin për pikën e parë në botëror. Humbje pësuan edhe nga Argjentina për renditje më të mirë.

Kosova në botëror u paraqit me simbolet tona shtetërore, përkundër se Spanja është kundërshtare e madhe e Pavarësisë së Kosovës.

Handball wrote history in Spain

The Kosovo U-21 National handball team became the first to participate in a world team sports championship, held in July 2019 in Pontevedra, Spain.

Although they only ranked 23 out of 24 countries, our boys made for a great impression even against national teams that were set to win the world championship.

The Group including Kosovo was rather strong, and a successful fare was rather difficult. Apart from Croatia, our National team lost against Hungary, Portugal and Brazil. At the end, it drew with Bahrain for the first point in the world championship. Kosovo also lost against Argentina, which would have gotten us a better ranking.

In the world championship, Kosovo was presented with our state symbols, despite Spain being a major opponent of Kosovo's independence.



Kosova përparon për 21 vende

Kombëtarja e Kosovës në basketboll ka përparuar për 21 vende në renditjen më të re të FIBA-s, të publikuar në shtator. Kombëtarja jonë ndodhet në vendin e 69-të (duke përfshirë edhe gjeneratat e reja). Kosova ka grumbulluar 124 pikë, ndërsa vlerësohet njëra prej vendeve me ngritjen më të madhe në botë.

Kosovo advances for 21 positions

The Kosovo national basketball team has advanced for 21 positions in the newest rankings of FIBA, published in September. Our National team is now in the 69th place (including younger generations) Kosovo has gotten 124 points, and is found to be one of the countries with the highest advance in the world.



Shalës i iku për pak norma Olimpike Tokio 2020

Egzon Shala ka përfunduar në vendin e shtatë në kampionatin botëror të mundjes, të mbajtur në Astana të Kazakistanit.

Mundësi ynë garoi në kategorinë -125 kg dhe me pak fat ka mundur të dalë i pesti.

Egzoni ishte duke fituar nga siriania Badza Khutaba në repesazh, por që kundërshtari riktheu rezultatin.

Është ky sukses i madh i Shalës. Gjashtë vendet e para fituan normën Olimpike.

Shala just missed the Tokyo 2020 Olympic norm

Egzon Shala came out seventh at the World Wrestling Championship, held in Astana, Kazakhstan.

Our wrestler competed in the 125kg category, and with a little luck, he could have been fifth.

Egzon was winning against Syria's Badza Khutaba in repessage, but the opponent recovered his game.

This is a great success for Shala. Six leading positions won their Olympic grades.



Atletika me tri medalje në Ballkanik

Musa Hajdari ka fituar medaljen e dytë të argjendtë brenda dy ditësh në kampionatin ballkanik të atletikës, që po mbahet në Pravets të Bullgarisë.

Derisa një ditë më paër kishte fituar medaljen në disiplinën 1500 metra, bursisti Olimpik Tokyo 2020 doli i dyti në 800 metra.

Në Ballkanik medaljen e argjendtë e fitoi edhe Greqa Bakraqi në disiplinën 3 000 metra.

Athletics gets three medals in the Balkans Championship

Musa Hajdari won his second silver in two days at the Balkan Athletics Championship, which is being held in Pravets, Bulgaria.

While the day before, he had won a medal in the 1500 m competition, the Tokyo 2020 Olympic Fellow Hajdari came in second in the 800m race.

In the Balkans Championship, there was also Gresa Bakraqi, who won a silver medal in the 3 000 meter race.



Katër medalje për boksin në turneun ndërkombëtar “Mustafa Hajrulahoviq”

Boksierët tanë kanë fituar katër medalje, prej tyre dy të arta dhe dy të argjendta, në turneun ndërkombëtar “Mustafa Hajrulahoviq Talija”, të mbajtur gjatë fundjavës në Bosnjë e Hercegovinë.

Patriot Behrami (69 kg) dhe Shpëtim Bajoku (64 kg) fituan të artat, ndërsa Besfort Merlaku (60 kg) dhe Besart Pireva (81 kg) fituan të argjendëtat.

Bajoku u shpall boksieri më teknik, ndërsa Behrami boksieri më luftarak. Drejtësinë e ndau edhe gjyqtari ndërkombëtar, Latif Demolli.

Four medals for boxing at “Mustafa Hajrulahovic” International Tournament

Our boxers won four medals, two of them gold and two silver medals, during the International Tournament “Mustafa Hajrulahovic Talija”, held over the weekend in Bosnia and Herzegovina.

Patriot Behrami (69 kg), and Shpëtim Bajoku (64 kg), both won gold medals, while Besfort Merlaku (60 kg) and Besart Pireva (81 kg) won silver medals.

Bajoku was declared the most technical boxer, while Behrami was the most combative boxer. Latif Demolli took part in administering the fights, as an international referee.



Medalja e parë ndërkombëtare për pingpongun

Ekipi i juniorëve të Kosovës ka fituar medaljen e parë ndërkombëtare, gjatë turneut të mbajtur në Maltë në muajin shtator 2019. Ekipi ynë u mund në finale nga Libani, 3:2 në sete.

Medaljen e bronztë në individuale e fitoi Kreshnik Mahmuti. Ai pati bilanc prej pesë fitore dhe një humbje.

A first international table tennis medal

The Kosovo Juniors team won the first international medal in a tournament held in Malta in September 2019. Our team was defeated in the finals by Lebanon, 3:2 in sets.

A bronze medal in individual competitions was won by Kreshnik Mahmuti. He had a balance of five wins and one loss.



Organizim madhështor i Tour of Kosova 2019

Federata e Çiklizmit e Kosovës organizoi edicionin e 19-të të garës ndërkombëtare "Tour Of Kosova 2019", e para e pranuar ndërkombëtarisht dhe që organizohet nën ombrellën e Federatës Botërore të Çikzlimit dhe asaj të Evropës

Tour of Kosova është klasifikuar me shkallën 2.2 të vlerësimit, që i bie se është një shkallë tureve më të mëdha si ai i Francës, Italisë apo Spanjës.

Rreth 100 çiklistë nga shtete të ndryshme të Evropës garuan në tri etapa nëpër rrugët e ndryshme të Kosovës.

Komiteti Olimpik i Kosovës ishte njëri nga sponsorët.

A majestic organization of the Tour of Kosovo 2019

The Kosovo Cycling Federation organized the 19th edition of the International Race "Tour Of Kosovo 2019", the first internationally recognized competition, organized under the umbrella of the World and European Cycling Federations.

The Tour of Kosova competition was given a 2.2 score in assessment, which means that it may compare to the major competitions, such as the Tour de France, Italy or Spain.

Around 100 cyclists from different European countries competed, in three stages, on different roads of Kosovo.

The Kosovo Olympic Committee was one of the sponsors.




iutecredit
Kredi në **10 min**
Vetëm me letërnjoftim
QATU PËR QATU!
www.iutecredit.org
038 40 60 80